

Njoftim
për shpalljen e kritereve për pozicionin Sanitar, në Akademinë e Sigurisë.

Akademia e Sigurisë shpall konkursin për 1(një) vend pune të lirë për personel administrativ, klasa I, funksioni **Sanitar**, në Sektorin Ekonomik, në Strukturën Administrative, në Akademinë e Sigurisë.

Kandidatët e interesuar për këtë vend pune duhet të plotësojë këto kritere;

1- Kritere të Përgjithshme

1. Te jete shtetas shqiptar me zotësi të plotë për të vepruar;
2. Të ketë përfunduar arsimin e mesëm;
3. Të jetë i aftë nga ana shëndetësore;
4. Të ketë figurë të pastër morale;
5. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë;

2- Kritere të veçanta

1. Të ketë eksperiencë pune të ngjashme;
2. Të ketë aftësi për të punuar në grup;

3- Kandidatët konkurrues duhet të paraqesin në Akademinë e Sigurisë dokumentat e mëposhtme:

1. Kërkesë me shkrim.
2. Kopje të njehsuar të dokumenteve të dëftesës përfshirë dhe listë notash, letërnjoftimi (ID). Diplomati që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;
3. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
4. Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
5. Vërtetim Gjykatë dhe Prokurorie.
6. Vërtetim i gjendjes shëndetësore;
7. Vërtetim nga Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK);
8. 2 fotografi me permasat 4x6.

Detyrat

- Të mbajë pastër ambientet zyrat, klasat, hotelin, etj (sipas ndarjes respektive);
- Te kryejë fshirjen, larjen, pastrimin dhe mirembajtjen e ambienteve dhe posteve të punës çdo ditë;
- Të mbajë në kontroll të vazhdueshëm higjenën, pastërtinë e objekteve dhe shesheve përreth, nëse konstaton humbje uji rrjedhje, plasaritje të tubave, saraçineskave, njofton menjëherë kujdestarin e objektit përkatës;

Dokumentat dorëzohen pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore në Akademinë e Sigurisë, brëndave 5 (pesë) ditëve pune nga moment i shpalljes.

Përzgjedhja e kandidatëve fitues do të bëhet nëpërmjet konkurimit me dosje dhe me intervista të drejtpërdrejta.